



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E MENAXHMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

SHPALLJE PER VENDE TË LIRA PUNE

Sektori I MZSH-së

**PUNONJËS TË SHËRBIMIT TË MZSH-SË PËR NIVELIN BAZË TË SHËRBIMIT
VENDOR TË MZSH-SË, SEKTORI I MZSH-SË BASHKIA MALLAKASTËR**

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015,date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07 2019” Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”, “Emërimi,lirimi dhe përjashtimi i personelit të Shërbimit të MZSH-së”dhe VKB nr.65 datë 24.12.2024 ”Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, Institucioneve në varësi, Funksioneve të Transferuara dhe deleguara për vitin 2025, VKB Nr.66 datë 24.12.2024 ” Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve ” dhe Vendimin Nr.04 datë 30.12.2024 “Për miratimin e strukturës, organikës, kategoritë/klasat e pagave për punonjësit e Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe të deleguara për vitin 2025, Bashkia Mallakastër shpall procedurat e konkurrimit për vend të lirë pune :

1(një) vend i lirë pune në pozicionin:

- Drejtues Mjeti 1(një) pozicion,në nivelin bazë,

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës;

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme,misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpetimi i jetës,gjësë së gjallë,pronës,mjedisit,pyjeve dhe kullotave ne aksidente të ndryshme,fatkeqësi natyrore,si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Drejtues Mjeti është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë, pronës, për çdo rast, aksident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme.

Organizon punën për rritjen e gatishmërisë së mjeteve, paisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në raste fatkeqësish.

Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri.

Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmerinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikes paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figure qytetare dhe humane.

-Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të jetë me vendbanim dhe vendqëndrim brenda territorit të Bashkisë Mallakastër
- g) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- gj) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.

h) Të ketë peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.

i) Kandidati për personelin **Drejtues automjetesh** zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, **grupi "D"**, si dhe me leje drejtimi të vecantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor.

-Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së.
2. Fotokopje e kartës së identitetit;
3. Saktësim adrese;
4. Certifikatë familjare;
5. Një kopje të jetëshkrimit (CV);
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Fotokopje dëftesë pjekurie;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)/Formular vetëdeklarimi;
12. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
13. Certifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
14. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike;
15. (dy) Fotografë (2.5 x 3.5 cm).

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave bëhet pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër ,brenda datës 18.06.2025.

-Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak të dokumentacionit ;

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mallakastër dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatit që plotëson kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidati i kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohet në mënyrë elektronike/email-mesazh, për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e pa kualifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike/email-mesazh për arsyet e mos kualifikimit. Afati I ankimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit

-Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi;

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me;

- Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- VKM nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri “

-Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve;

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohet fazave të konkurimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- d) Testimi psikologjik;
- e) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

-Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

-Testi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

-Testim i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Pikët maksimale të përcaktuara për këtë test janë 100. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

-Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

-Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të aplikantit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Kandidatët fitues do të renditen sipas nr. të pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mallakastër do të shpallë fituesit në Portalin “Shërbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mallakastër dhe standat e informimit të publikut.

Kandidatët jofitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Mallakastër. Afati i ankimimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

BASHKIA MALLAKASTËR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

LAURETA SALIAJ

JONIDA LLAKA

MERUSHE QALLIAJ

